



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AGJENCIA KOMBËTARE E UJËSJELLËS - KANALIZIMEVE

Nr. _____ Prot

Tiranë, më 04.12.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Datë 04.12.2024

Drejtuar: **Bashkim Operatorësh Ekonomik Shoqëria "STUDIOARCH4" shpk me NIPT L52122135Q**, me adresë: TIRANE Njesia Bashkiake nr.10, Rruga Besim Imami, Ndertesa nr.34, kati pare perdhe, **Shoqëria "ERSI/M" Sh.p.k me NIPT J98624803O**, me adresë: Ap. nr. 29, Hyrja 2, Pallati TID, Rruga "Marko Bocari", Tirane, **Shoqëria "C.E.C GROUP" Sh.p.k me NIPT L11807013M** me adresë: TIRANE Njesia Bashkiake nr.7, Rruga Dritan Hoxha, Ndertesa nr.117, Shkalla nr.2, Apartamenti nr.5/3.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur, Shërbim;

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Nr. REF - 15677-08-08-2024;

Përshkrimi i shkurtër i kontratës :“Studim Projektim Impiant i Trajtimt të Ujërave të Ndotura dhe sistemi KUZ, Jalë”;

Fondi limit: 22,652,500 (njëzet e dy milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Kohëzgjatja për realizimin e kontratës: 6 (gjashtë) muaj.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

* * *

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto **X**

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “A&E ENGINEERING” shpk L79326502O

Vlera: 19,450,000 Lekë (Nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë)Lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [279.00].

2. B.O.E. ”STUDIOARCH4” shpk L52122135Q

“ERSI/M” shpk J98624803O

“C.E.C GROUP” shpk L11807013M

Vlera: 19,421,102.5 Lek (Nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e njëzet e një mijë e njëqind e dy pikë pesë) Lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [274.50].

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “A&E ENGINEERING” shpk L79326502O

Vlera: 19,450,000 Lekë (Nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë)Lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [279.00].

S’Kualifikohet

Arsyet:

Pas kryerjes së procedurës së Vlerësimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave kërkoi nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari Shoqëria “A& E ENGINEERING” sh.p.k., që të paraqesë të gjithë dokumentacionin e paraqitur për procedurën e prokurimit në formën e kërkuar nga ligji, origjinal ose kopje të noterizuar.

Me shkresën Nr.748 Prot datë 16.09.2024 Operatori Ekonomik Shoqëria “A& E ENGINEERING” sh.p.k. me NIPT K72113010E, me adresë të selisë Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.10, Rruga “Islam Alla”, Pallati IVEA 3/5, protokolluar me tonën Nr.2693 Prot datë 16.09.2024, ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas verifikimit të të gjithë dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik i renditur i pari Shoqëria “A& E ENGINEERING” sh.p.k., konkludon se

Operatori Ekonomik i renditur i pari **nuk disponon** “*Pajisje për matjet batrimetike single dhe multi-beam së bashku me motobarkën për realizimin e këtyre matjeve*” për këto arsye:

Në Dokumentat Standarte të Tenderit Shtojca 8, Kapitulli 2.3 Kapaciteti Teknik, Paragrafi 2.3.8. nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar kriteri si më poshtë:

2.3.8 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qera Pajisjet Gjeodezike si më poshtë:

- 1 (një) Pajisje për matjet batrimetike single dhe multi-beam së bashku me motobarkën për realizimin e këtyre matjeve.

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënsit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike. Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t`u kërkuar sqarime nga AK. Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Rezultoi se nga ana e Operatorit Ekonomik Shoqëria “A & E ENGINEERING” sh.p.k është paraqitur dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor. Por, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik, konkretisht Faturë Nr. 245 datë 05.07.2017, rezulton se pajisja në këtë faturë nuk plotëson kriterin e kërkuar në DST për “***Pajisje për matjet batrimetike single dhe multi-beam së bashku me motobarkën për realizimin e këtyre matjeve***”, Pasi kjo pajisje është vetëm single beam dhe nuk ka funksionalitetin multi-beam të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Përsa më sipër, qenë në këto kushte, në referim të legjislacionit për prokurimin publik si dhe duke konstatuar se ky kriter nuk rezulton i përmbushur nga Operatori Ekonomik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor, vendosi të s’kualifikojë Operatorin Ekonomik Shoqëria “A & E ENGINEERING” sh.p.k.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **Bashkim Operatorësh Ekonomik Shoqëria ”STUDIOARCH4” shpk** me NIPT L52122135Q, me adresë: TIRANE Njesia Bashkiake nr.10, Rruga Besim Imami, Ndertesa nr.34, kati pare perdhe, **Shoqëria ”ERSI/M” Sh.p.k** me NIPT J98624803O, me adresë: Ap. nr. 29, Hyrja 2, Pallati TID, Rruga "Marko Bocari", Tirane, **Shoqëria ”C.E.C GROUP”Sh.p.k** me NIPT L11807013M me adresë: TIRANE Njesia Bashkiake nr.7, Rruga Dritan Hoxha, Ndertesa nr.117, Shkalla nr.2, Apartamenti nr.5/3, me vlerë

të ofertuar 19,421,102.5 Lek (Nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e njëzet e një mijë e njëqind e dy pikë pesë) Lekë pa TVSH/ totali i pikëve të marra [274.50] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës-Kanalizime, me adresë: "Sami Frashëri", Nr.4, Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO ☒ JO ☐

Vendimi Nr.1627/2024, datë 18.11.2024 i Komisionit të Prokurimit Publik.

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO ☐ JO ☐

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Klevis JAHAJ